



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 59

Prishtinë, më 15.4.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj dhe Raif Qela nga Komisioni për Zhvillimin Ekonomik.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi, Valdete Bajrami dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha-OSBE, Azajmi Beseviç- “BETA”; Driton Vitia-“Kosova Sot”, Ridvan Slivova-“Telegrafi”, Dren Ajeti- GLPS, Habib Hasani- MI, Shqipe Osmani- “Botapres”, Norë Shabani- “Koha Ditore”, Agon Foniqi- “Kosova Sot”, Kaltrina Rexhepi- BIRN; Naser Shosholli dhe Shehrie Leci – MAP, Zsofia Czoma dhe Mariana Gyorkos- Projekti i Binjakëzimit, Milaim Ali, Fëllanza Mekuli dhe Enis Spahiu- MF, Dredhëza Ahmetxhekaj- “Rrokum TV”, Emrush Haxhiu, Fehmi Pireva dhe Armend Ademaj- Kuvendi i Kosovës dhe Fitore Berisha- ZRPK.

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Nga Stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente, i Komisionit Funkcional në Projektligjin Nr. 05/L-061, për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryesuesja propozoi që rendi i ditës të fillojë me shqyrtimin e amendamenteve të Komisionit Funksional, në Projektligjin Nr. 05/L-064, për Patentë Shofer, pasi që kemi përfaqësues nga Komisioni Funksional, ndërsa në pikën të ndryshme, të formohet grupi punues për Projektligjin e Procedurës Administrative, sipas vendimit të seancës dhe diskutimi për Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Verifikim dhe Krahësim të Pronave.

2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin Nr. 05/L-064 për Patentë Shofer.

Armend Zemaj, tha se Kuvendi në seancë plenare vendosi që Projektligjin për Patentë shofer ta dërgojë në lexim të tretë. Komisioni për Legjislacion, si komision kryesor për shqyrtimin e këtij Projektligji, ka pasur vërejtje në disa nene dhe këto vërejtje janë marrë parasysh në Komisionin Funksional, para dërgimit të raportit në seancë plenare. Dy çështje që kanë mbetur të diskutohen dhe që nuk e kanë marrë përkrahjen e Kuvendit; janë **amendamenti 4**, i cili nënkupton se shteti mund të lëshojë dy lloje të patentë shoferëve, një për lëvizje brenda vendit dhe një për lëvizje jashtë vendit. Për më tepër fjalët “ Është një patentë shoferi e përkthyer në shumë gjuhë...” është e pakuptimtë sepse do të duhet të caktohej një format me standardet ndërkombëtare, që do të vlejë në të gjitha shtetet, dhe **amendamenti 17** i Projektligjit, ku duhet të hiqen fjalët “*në të holla*” sepse formulimi është joadekuat, ngase rregullatori aktual ligjor nuk e njih këtë lloj formulimi, ngase dihet që gjopa paguhet në të holla dhe nuk ka nevojë të thuhet ‘*me gjorbë në të holla*’.

Si deputet kam kërkuar nga Zyra për Hulumtime Legjislative që të bëjë një hulumtim rreth terminologjisë së përdorur për patentë shofer ndërkombëtar. Ndryshimet që janë bërë tani edhe nga Komisioni Funksional, përkohë me kërkesën tonë në seancë plenare. Në seancë plenare amendamenti i paraqitur ka qenë vetëm si përkufizim dhe në pjesën përfundimtare nuk ka qenë i sqaruar se çfarë është patentë shoferi ndërkombëtar, pse duhet të përdoret, cilat janë praktikatat e vendeve tjera dhe a është nënkuptuar nga kjo që organi kompetent duhet të lëshojë dy lloje të patentë shoferit. Riformulimi që e ka bërë Komisioni Funksional, mendoj se te pjesa përmbajtësore e nenit duhet të përcaktohet se kush e lëshon këtë lloj dokumenti, sepse pjesa e parë flet vetëm për organin kompetent, ndërsa në vendet e tjera është e përcaktuar edhe pse në praktikatat e reja kjo është një direktivë e përdorur qysh në vitin 1968, dhe e cila është bërë me qëllim për t’i eliminuar barrierat në vendet dhe sistemet e ndryshme që kanë qenë. Në vitin 2000, po ashtu, është miratuar një rezolutë e Komisionit, e cila i njih të vlefshme të gjitha patentat e shoferëve, të cilat janë të lëshuara brenda zonës evropiane. Ky është një dokument i përkohshëm që nuk kërkohet, por mund të lëshohet në përdorim afatshkurtër! Mirëpo, varet se si do ta përcaktojë organi dhe se vlefshmëria e tij e ka vetëm këtë qëllim. Si Komision pajtohem si është riformuluar ky nen sepse nuk lejon të ketë dykuptimësi të patentë shoferit. Do ishte mirë që në pjesën përmbajtësore, aty te neni 96-97, të merret për bazë hulumtimi që e ka bërë Zyra për Hulumtime e Kuvendit dhe të specifikohet në detaje ky lloj dokumenti, të përcaktohet organi që e ka lëshuar këtë dokument, sepse këtu nënkuptohet që atë e bën auto-shkolla dhe kjo nuk është praktikë e asnjë vendi që e lëshon këtë dokument.

Ka shtete të cilat kanë Agjenci të caktuar, ka shtete që ato i lëshon Ministria Punëve të Brendshme, apo praktika të tjera. Sa i përket amendamentit 4, mendoj që duhet ta përkrahim riformulimin që e ka bërë Komisioni për Zhvillim Ekonomik, theksoi Zemaj.

Raif Qela, theksoi se Projektligji për Patentë Shofer shkoi në lexim të tretë për dy çështje: e para për çështjen e amendamentit “**dënohet me gjobë në të holla**” dhe e dyta, për amendamentin lidhur me përkufizimin për patentë shofer ndërkombëtar. Së pari, Komisioni për Zhvillim Ekonomik dhe Industri, mbetet pranë qëndrimit të vet se patentë shofer ndërkombëtar, duhet të ketë, sepse është i domosdoshëm për një pjesë të qytetarëve, të cilët udhëtojnë jashtë vendit, në ato vende të cilat nuk u njihet patentë shoferi i lëshuar në Republikën e Kosovës, vetëm në gjuhën angleze, serbo-kroate dhe shqipe.

Kërkohej që institucionet përkatëse, për ata të cilët shkojnë jashtë vendit si turistë apo ndërrojnë përkohësisht vendbanimin, të pajisjen me patentë shofer ndërkombëtar.

Që të hiqen dilemat, se a duhet të jetë kjo e domosdoshme apo jo, e bëjmë një riformulim në mënyrë që kjo të jetë e pranueshme dhe mos të lërë vend për keqkuptime.

Komisioni qëndron pranë mendimit se formulimi, dënohet për kundërvajtje me gjobë në të holla është i saktë, sepse kjo nuk ka të bëjë me legjislacionin, por ka të bëjë me terminologjinë.

Qela, më tej tha se fjalori i sotëm i gjuhës shqipe jep shpjegimin se gjoba është detyrim, zakonisht në të holla, që caktohet si dënim për thyerjen e një rregulli, për një dëmtim, për mosplotësim të kushteve të një marrëveshjeje ose për shkelje jo të rënda të ligjeve. Shembulli i parë në fjalor shpjegues është gjoba në të holla. Gjoba ka qenë si mjet i ndëshkimit deri vonë në Ballkan, jo vetëm dënimi me të holla, por edhe gjobë në natyrë. Gjoba nuk është vetëm dënim në të holla, por edhe në forma të tjera dhe përderisa është në forma të tjera, pavarësisht se është thënë në Kodin Penal se duhet të jetë gjobë dhe nuk e ka precizuar se çfarë lloj i gjobës është. Përderisa fjalori e thotë qartë se “gjoba është zakonisht në holla”, do të thotë që mund të ketë edhe forma të tjera të gjobës.

Ndërsa, sa i përket pjesës tjetër, ashtu si e tha edhe z. Zemaj, ka nevojë të riformulohet ky amendament në këtë mënyrë: *Patentë Shoferi Ndërkombëtar është dokument i nxjerrë sipas kërkesës së palës, i cili i mundëson mbajtësit të tij që ta drejtojë automjetin në ato shtete jashtë Kosovës, të cilat e kërkojnë këtë dokument plotësues, sipas Konventës së Vjenës të Trafikut Rrugor të 8 nëntorit të vitit 1968. Është një dokument plotësues i përkthyer në shumë gjuhë, i cili përshkruan të dhënat nga patentë shoferi, të nxjerrë nga institucioni përkatës i shtetit të origjinës të pronarit të patentës, që ka fotografi të drejtuesit të automjetit dhe të dhëna relevante mbi të drejtën për drejtim. Ky dokument nuk i lejon pronarit të tij që ta drejtojë automjetin në vendin e origjinës.*

Meqë nuk kishte diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-064 për Patentë Shofer dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm;
2. Komisioni përkrahu propozimin për amendamentin 4, i riformuluar nga Komisioni Funkcional, kurse nuk e përkrahu formulimin aktual për amendamentin 17, me vërejtjet e njëjta, si në raportin e datës 11.3.2016;
3. Projektligji dhe amendamentet e propozuara, mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Grupit Punues në Projektligjin nr.05/L061, për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës;

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim Raportin me amendamente të Komisionit Funkcional, në Projektligjin nr. 05/L-061, për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-061, për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Shqyrtimi i Projektligjit të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Kryesuesja Selvije Halimi tha se të pranishëm janë përfaqësues nga Projekti i Binjakëzimit, Ministria e Financave dhe përfaqësues nga Ministria e Administratës Publike, kurse nuk marrin pjesë përfaqësuesit nga Zyra e Kryeministrit, edhe pse janë ftuar.

Znj. Halimi njoftoi se dhe gjatë ditës kanë zhvilluar disa takime me përfaqësuesit e Projektit të Binjakëzimit dhe Zyrën e BE-së, së bashku me z. Zemaj, që është kryesues i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit dhe që e kryeson punën e Projektligjit për Kuvendin.

Më tej ata u pajtuan që të mbajnë një takim pune me anëtarët e Komisionit për Mandate Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit, së bashku me përfaqësues të Projektit të Binjakëzimit, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Administratës Publike dhe Zyrën e BE-së. Pasi t'i shqyrtojnë komentet që do të dalin, në mbledhjen e radhës do ta procedojmë në Kuvend, Projektligjin për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Armend Zemaj, u pajtua që të ketë një takim pune për Projektligjin për Kuvendin, por tha se përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe ata të Ministrisë së Administratës Publike, duhet ta kenë të qartë se përse po ftohen: e para MF-ja ka të bëjë me koston buxhetore që pretendohet se mund të kenë të dyja draftin e Projektligjit, dhe e dyta MAP-i, krijimi sistemit unik për të gjithë shërbyesit civilë, sepse me këtë Projektligj preket kjo fushë.

Meqë nuk pati diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Komisioni u pajtua që të mbahet një takim pune, i mbyllur më 21.4.2016, në orën 11:00, i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit, për të shqyrtuar Projektligjin

për Kuvendin, duke ftuar përfaqësuesit e Projektit të Binjakëzimit, ata të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Administratës Publike dhe Zyrës së BE-së.

5. Të ndryshme.

A. Formimi i Grupit Punues për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Komisioni vendosi që të formohet një Grup Punues për Shqyrtimin e Projektligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në këtë përbërje:

1. Selvije Halimi,
2. Armend Zemaj,
3. Agim Aliu

B. Diskutim për Projektligjin Agjencinë Kosovare për Verifikim dhe Krahësim të Pronave

Komisioni vendosi që të hënën, më 18.4.2016, të mbledhet Grupi Punues për Agjencinë Kosovare për Verifikim dhe Krahësim të Pronave, që më tej të procedohet për Kuvend.

C. Njoftim

Selvije Halimi, kryetare i njoftoi anëtarët e Komisionit se Komisioni për Legjislacion ka pranuar shkresë nga Këshilli Gjyqësor dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor të Kosovës, me ç'rast kanë shtruar kërkesën për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve për KGJK-në dhe KPK-në. Kryesisht ndryshimet janë kërkuar me parashkrimin e lëndëve, e të cilat duhet të jenë të përfshira në të dy ligjet. Komisioni duke parë nevojën se ligjet në fjalë paraqesin pengesë në punën e institucioneve të theksuara dhe duke pas parasysh faktin se nisma legjislative nga Kuvendi do të marrë shumë kohë, dhe me qëllim të adresimit të shqetësimeve me kohë, rekomandohet që këto dy ligje të përfshihen në Programin legjislativ 2016. E njëjta shkresë i është përcjellë Ministrisë së Drejtësisë, që të bëjë këtë nismë legjislative dhe nuk kemi ndonjë informacion zyrtar se a ka ndërmarrë diçka, sa i përket kësaj nisme.

Në të njëjtën kohë, kemi kërkesën që të përshpejtohet kjo nisëm për ndryshimin e afateve, sepse kjo po paraqet problem në parashkrimin e lëndëve.

Armend Zemaj, tha se kemi rekomanduar që këto dy ligje të plotësohen dhe të kthehet afati i vjetër. Ne, si Komision, mund të kërkojmë sqarim, pse deri më tash nuk pati ndonjë veprim për projektligjet e cekura.

Meqë nuk pati diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanimit nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Komisioni vendosi që të organizojë një takim të përbashkët me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, KPK-së, KGJK-së dhe ZPD-së, për të diskutuar rreth kësaj çështje.

Komisioni vendosi që mbledhja e radhës të mbahet më 19.4.2016, në orën 10:00.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Fatbardha Boletini

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi